FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 134

Tiranë – E enjte, 14 shtator 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 77/2023, datë 14.9.2023	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë.....	15621
Vendim i Kuvendit nr. 78/2023, datë 14.9.2023	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë.....	15621
Vendim i Kuvendit nr. 79/2023, datë 14.9.2023	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.....	15621
Urdhër i Kryeministrit nr. 125, datë 12.9.2023	Për delegim kompetence.....	15621
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 8.9.2023	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e klasave të arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë.....	15622
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 6.9.2023	Për një ndryshim në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre"	15623
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 453/10, datë 11.9.2023	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim asfaltim i segmentit rrugor Taulla Sinani–Esma Dervishi në lagjen 'Xhevdet Nepravishta', Lushnjë".....	15624

VENDIM
Nr. 77/2023

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe dekretit nr. 193, datë 9.9.2023, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 193, datë 9.9.2023, për shkarkimin e zonjës Delina Ibrahimaj nga detyra e ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.9.2023.

VENDIM
Nr. 78/2023

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe dekretit nr. 199, datë 9.9.2023, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 199, datë 9.9.2023, për emërimin e zotit Ervin Mete në detyrën e ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.9.2023.

VENDIM
Nr. 79/2023

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe dekretit nr. 205, datë 9.9.2023, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 205, datë 9.9.2023, për emërimin e zonjës Delina Ibrahimaj në detyrën e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.9.2023.

URDHËR
Nr. 125, datë 12.9.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Departamentit të Administratës Publike, z. Ened

Kërçini, drejtor i Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike, në Departamentin e Administratës Publike.

2. Delegimi i kompetencave fillon për periudhën nga data 12.9.2023 deri në plotësimin e pozicionit të drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, sipas procedurave ligjore.

3. Për realizimin e kompetencave në pozicionin e drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, z. Kërçini ka të drejtë të kryejë çdo veprim të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

4. Ngarkohet z. Ened Kërçini, drejtor i Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike, në Departamentin e Administratës Publike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 21, datë 8.9. 2023

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

1. Në shkollat e arsimit bazë mund të krijohen klasa të arsimit të orientuar, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Shkollat e arsimit bazë, ku krijohen klasa të arsimit të orientuar, duhet të plotësojnë kushtet infrastrukturore, personelin mësimor të specializuar, si dhe bazën materiale dhe didaktike të nevojshme për zhvillimin e mësimit në klasën e arsimit të orientuar, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Nxënësit që pranohen në klasat e arsimit të orientuar të arsimit bazë, kurrikulën e përgjithshme e zhvillojnë të përbashkët me nxënësit e tjerë, ndërsa lëndët e specialitetit i zhvillojnë të veçanta.

4. Plani mësimor i këtyre klasave në arsimin bazë, miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin.

5. Programet mësimore të lëndëve të specialitetit për klasat e arsimit të orientuar në arsimin bazë, hartohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

6. Norma mësimore për mësuesit e lëndëve të specialitetit përcaktohet sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar.

7. Shkollat e arsimit bazë ku krijohen klasa të arsimit të orientuar miratohen nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP), pas propozimit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

8. Kërkesat për pranimin e nxënësve në klasat e arsimit të orientuar bëhen në shkollën përkatëse nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësin.

9. Kriteret e pranimit të nxënësve në klasat e arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë dhe dokumentacioni përcaktohen nga shkolla përkatëse dhe miratohen nga ZVAP-i.

KREU II
PROCEDURAT PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR ME DREJTIM ARTISTIK NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

1. Pranimi i nxënësve në klasat e arsimit të orientuar me drejtim artistik në shkollat e arsimit bazë bëhet me konkurs.

2. Konkursi për pranimin e nxënësve në klasat e arsimit të orientuar me drejtim artistik në shkollat e arsimit bazë zhvillohet sipas datave të përcaktuara nga ZVAP-i. Datat e konkursit afishohen në një vend të dukshëm të shkollës dhe publikohen në faqet e internetit të shkollës dhe të ZVAP-it.

3. Përzgjedhja e nxënësve për klasat e orientuara me drejtim artistik në shkollat e arsimit bazë bëhet nga komisioni i ngritur nga drejtori i shkollës.

4. Komisioni i përzgjedhjes përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, përkatësisht 1 (një) mësues që mbulon lëndën e specialitetit në shkollë, 1 (një) mësues i përcaktuar nga ZVAP-i që mbulon lëndën e specialitetit përkatës në një shkollë tjetër brenda juridiksionit të ZVAP-it dhe 1 (një) përfaqësues i ZVAP-it.

5. Komisioni afishon në shkollë dhe në faqen e saj të internetit listën e fituesve, jo më vonë se 1 (një) ditë pas zhvillimit të konkursit. Lista firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Procesi i konkurrimit monitorohet nga DRAP-i.

6. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësin gëzon të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

7. Në përfundim të procesit të konkursit, komisioni harton procesverbalet përkatëse, të cilat administrohen në drejtorinë e shkollës.

KREU III
PROCEDURAT PËR KRIJIMIN E KLASAVE TË ARSIMIT TË ORIENTUAR TË PROFILIZUARA NË SPORT NË SHKOLLAT E ARSIMIT BAZË

1. Klasat e arsimit të orientuar të profilizuara në sport krijohen në disiplina të ndryshme sportive, sipas kërkesave të nxënësve.

2. Krijimi i klasave të profilizuara në sport, referuar elementeve bazë teknike dhe fizike të nxënësve, bëhet pas përfundimit të arsimit fillor (AF), mbështetur në kërkesën e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për to.

3. Krijimi i klasës së profilizuar në sport nis nga klasa VI, për të vijuar në vitet në vazhdim deri në klasën IX.

4. Klasat e profilizuara në sport krijohen në një disiplinë të vetme sportive ose në dy disiplina sportive të kombinuara (djemtë në një disiplinë, vajzat në disiplinën tjetër).

KREU IV
DISPOZITAT E FUNDIT

1. Procedurat e pranimit të nxënësve në klasat e arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë janë objekt i inspektimit dhe i vlerësimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit para-universitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

VENDIM
Nr. 42, datë 6.9.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të nenit 60, pika 1, dhe të nenit 69, pika 6, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

i. Në nenin 5, pika 8/1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"*8/1. SHKK-ja, për çdo pagesë dhe/ose shtesë të kapitalit nga çdo anëtar dhe/ose fondet e donatorëve nën vlerën 100,000 lekë, përveç kontributeve që shërbejnë si kusht për anëtarësimin në SHKK, siguron dhe mban në dosje të veçanta dokumentacionin e parashikuar në shkronjën "f", nënpika "iii" ose në shkronjën "g", nënpika "iii" të pikës 2, të nenit 6 të kësaj rregulloreje.*".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË
Nr. 453/10, datë 11.9.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim asfaltim i segmentit rrugor Taulla Sinani–Esma Dervishi në lagjen 'Xhevdet Nepravishta', Lushnjë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "truall", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 785,987 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "SISTEMIM ASFALTIM I SEGMENTIT RRUGORE TAULLA SINANI–ESMA DERVISHI NË LAGJEN 'XHEVDET NEPRAVISHTA'"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										TRUALL			NDËRTESË			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)		
	A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*J*	*K*	*O*	*P*	*Q*	*R*	*S*	*T*	*Y*	*Z*
1	VERGJIL HATIXHE	AVNI ISUF	SINANI SINANI	LUSHNJË	8571	26/110	TRUALL	270	0	270	138	26	191	13.0	9709	126217	0.0	0	0	126217	Sek. E: Godinë banimi 3-katëshe; sip. Katesh: kati përdhes 138 m^2, kati I 191 m^2, kati II 145m^2.
2	SHPRESA ALKETA KELMEND	MUSTAFA XHEMAL XHEMAL	SINANI SINANI SINANI	LUSHNJË	8571	26/107	TRUALL	1412	0	1412	84			25.0	9709	242725	0.0	0		242725	Sek. E: Vendim k. k. pronave (banesë1-katëshe)
3	FATOS LULJETA	HASAN RIZA	SHEHU SHEHU	LUSHNJË	8571	26/4	TRUALL	144	0	144	48	27	84	7.8	9709	75730	0.0	0	0	75730	Sek. E: Leje legalizimi nr. 39999, datë.25.1.2017, godinë banimi kati. I, sip. ndërtimi 48 m^2, sip. parcele 144 m^2
4	PETRO VALI	REXHEP RAMAZAN	SINJARI SINJARI	LUSHNJË	8571	26/234	TRUALL	337	0	337	169			20.7	9709	200976	0.0	0	0	200976	Sek. E: Godinë banimi 3-katëshe, sip. kati përdhes ekonomik 169 m^2; sip. kati I banim 194 m^2; sip. kati II banim 169m^2
5	HIQMET QEMAL	PASHO PASHO	META META	LUSHNJË	8571	26/150	NDERTESË	66	0	0	66	0	0	0.0	0	0	8.7	0	140338	140338	
										SHUMA						**645649**			**140338**	**785987**	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 134
Datë: 2023/09/14 15:43:02
41eeff55-7c3f-4f39-a2a4-4f7c88a7b618

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë